

together ness

Edicioni XXIII Edition

5 > 8.11.2024

Prishtinë & Prizren - Republika e
Kosovës Republic of Kosovo

remusicafestival.com



Program 2024

TUESDAY

05.11 – Prishtinë

11:00

Festivals around table City and festivals
Festivalet rreth tryezës: Qyteti dhe Festivalet

Diskutim mbi marrëdhënien mes festivaleve dhe qytetit |
A discussion focusing on the relationship between festivals
and the city.

📍 Europe House Pristina, Kosova

12:00

ReMusica Junior Ndërtojmë instrumente muzikore me mate-
riale ricikluese
| Musical Instruments Using Recycled Materials

Punëtori: Me materiale ricikluese fëmijët do të ndërtojnë
instrumentet muzikore

📍 Barabar Centre Prishtinë, Kosovë

14:00

Meet the artists - Bisedë me *conversation with* Elbenita Kajtazi-soprano, Petrit Çeku-kitarist guitarist dhe Simon Mundy-kolumnist në *columinst in* Eye On London dhe
Writer in Residence në Continuo Connect | A conversation
between Elbenita Kajtazi- soprano, Petrit Çeku- guitarist
and Simon Mundy- columnist in Eye On London and Writer
in Residence in Continuo Connect

Biseda fokusohet në rrugëtimin e tyre artistik, frymëzimin
dhe historitë personale / The conversation delves into their
artistic journeys, inspirations, and personal stories

📍 Barabar Centre Prishtinë, Kosovë

Edizioni XXIII Edition

togetherness

16:00

Pocket concert *ON THE EDGE* MARGHERITA
BERLANDA *fizarmonikë / accordion*

Program: M. Tsangaris, R. Vetrano, S. Odeh-Tamimi, A.
Sowa

📍 Barabar Centre Prishtinë, Kosovë

19:00

Concert ELBENITA KAJTAZI soprano & ELDA LARO
piano

Program: C. Debussy, F. Liszt, E.W. Korngold, M.G.
Puccini, J. Rachmaninov, P.I. Tchaikovsky

📍 Atelieja e Pallatit të Rinisë, Prishtinë, Kosovë



Concert SIPARANTUM CHOIR
MEMLI KELMENDI dirigjent conductor

Program: J. Ames, Baki Jashari, M. McGlynn, J.V. Roost,
K. Gimon, J. Poelinitz, J. Runestad, S. Vovk

📍 Atelieja e Pallatit të Rinisë, Prishtinë, Kosovë

WEDNESDAY

06.11 – Prizren

9:30

Artists and festivals around table The importance of sup-
porting emerging artists in festival programmes | *Artistët*
dhe festivalet rreth tryezës:

Rëndësia e përkrahjes së artistëve në zhvillim
Moderuar nga Moderated by Simon Mundy, columnist
në Eye On London dhe Writer in Residence në Continuo
Connect / columnist in Eye On
London and Writer in Residence in Continuo Connect

📍 Institut Français du Kosovo, Prishtinë, Kosovë

12:00

ReMusica Junior World of Sounds / Bota e Tingujve

Join us in discovering and exploring the world of sounds.
Let's become sound explorers! Bashkohuni me ne në
zbulimin dhe eksplorimin e botës së tingujve. Ejani të
eksplorojmë së bashku botën e tingujve!

📍 Autostrada Biennale Hangar, Prizren, Kosovë

15:00

Pocket concert Koncert Akusmatik | Acousmatic Concert:
JEAN BAPTISTE ZELLAL

Program: J.B. Zellal, S. Delafontaine, L. Mormont, D.Rudi

📍 Autostrada Biennale Hangar, Prizren, Kosovë

16:00

Pocket concert WIND ENSEMBLE

NITA KRAJKU, flaut *flute* | XHOVANA MARKU, oboa *oboe* |
MALBORË KRAJKU, klarinetë *clarinet* | ZANË XHULI, fagot
bassoon | ARDITA IBRAHIMI, korno *horn*

📍 Autostrada Biennale Hangar, Prizren, Kosovë

17:00

Festivals around table The Role of Festivals in Climate
Action and Environmental Awareness towards Net-Zero

*Festivalet rreth tryezës: Roli i Festivaleve në veprimin klima-
tik dhe ndërgjegjësimin mjedisor drejt Net-Zero*

📍 Autostrada Biennale Hangar, Prizren, Kosovë

19:00

Concert RAQUEL ANDUEZA soprano & JESUS FERNANDEZ BAENA theorbo

Program: E. Radesca, F. Cavalli, J. Lully, M. Charpentier, J. de la Barre, Spanish and Italian music of the 17th Century

📍 Katedralja "Zoja Ndihmëtare" Prizren, Kosovë The Cathedral of Our Lady of Perpetual Succour



Concert ReVocal Ensemble

ANDRA REXHEPI alt | ELONA SADIKU soprano | DIELLZA SYLEJMANI alt | FATJON GASHI tenor | KALTRINA MIFTARI soprano | NIKOLL GJINI bas | RIZAH JAHAJ tenor | SAFET BERISHA tenor | SHABAN BEHRAMAJ bariton | SHKURTA HYKAJ REXHEPI soprano

RAFET RUDI dirigjent conductor

Program: Mendi Mengjiqi, L. Jekabsone, C. Monteverdi, Rafet Rudi, J. Dowland, E. Ešenvālds, M. Lauridsen, A. Lotti, Lorenc Antoni, Jan Kukuzel, J. Runestad, W. Byrd

📍 Katedralja "Zoja Ndihmëtare" Prizren, Kosovë The Cathedral of Our Lady of Perpetual Succour

THURSDAY

07.11 – Prishtinë

12:00

Concert ReMusica Junior - ORKESTRA E FEMIJËVE TE PRISHTINËS / CHILDREN'S ORCHESTRA OF PRISTINA VEHBİ SHOSHOLLI dirigjent conductor

Program: N. Rota, D. Shostakovich, P. Gaci, A. Menken, S. Kolonja, F. Ibrahim, J. Strauss, R. Krasniqi

📍 Atelieja e Pallatit të Rinisë Prishtinë, Kosovë

19:00

Concert ReNEW: DIAR ALIU kitarë guitar & Amati String Quartet

Program: M. Giuliani, F. M. Torroba, M. Castelnuovo-Tedesco, K. Penderecki, M. Villa-Lobos

📍 Atelieja e Pallatit të Rinisë, Prishtinë, Kosovë



Concert TRIO ELOGIO

PETRIT ÇEKU kitarë guitar | PEDRO RIBEIRO RODRIGUES kitarë guitar | TOMISLAV VUKŠIĆ kitarë guitar

Program: W. A. Mozart, B. Vlahek, S. Dodgson, F. Schubert

📍 Atelieja e Pallatit të Rinisë, Prishtinë, Kosovë

FRIDAY

08.11 – Prishtinë

12:00

Promovim i Librit Skena Muzikore e Prishtinës - Festivali i Parë i Muzikës Klasike në Kosovë (1974 - 1988) Jubileu i 50 vjetorit të themelimit
Autore: Kristina Palokaj Perkola

19:00

Concert Melodies of the Heart *Meloditë e Zemrës*

FLAKA GORANCI mezzo-soprano & TRINGA SADIKU kitarë guitar

Program: C. Domeniconi, M. de la Falla, A. Dvorak, V. Parra

📍 Atelieja e Pallatit të Rinisë Prishtinë, Kosovë



Koncert Autorial Rafet Rudi – 75 Vjetori

Kori i Filharmonisë së Kosovës | Marcio Da Silva | Petrit Çeku | Sihana Badivuku | Lirika Pula | Zanë Abazi | Tringa Sadiku | Diar Aliu

Mbrëmje për shënimin e 75-vjetorit të kompozitorit Rafet Rudi / *An evening celebrating the 75th anniversary of the composer Rafet Rudi.*

📍 Atelieja e Pallatit të Rinisë Prishtinë, Kosovë

8 January 2025

Post ReMusica: Special Event
WESTERN BALKANS YOUTH ORCHESTRA
Orkestra Rinore e Ballkanit Perëndimor

Mario Ruska, Klarinetë/Clarinet
Desar Sulejmani, Dirigjent/Conductor

Program: L.V.Beethoven, A.Copland, F.Mendelssohn-Bartholdy

📍 Atelieja e Pallatit të Rinisë, Prishtinë, Kosovë

Edicioni XXIII Edition
togetherness

TOGETHERNESS (SË BASHKU) – festa e muzikës, shumëllojshmërisë dhe vendit ku krijohen lidhje të qëndrueshme.

Edicioni i 23-të i Festivalit **ReMusica**, me temën "Togetherness - Së Bashku," paraqet një program të plotë katër ditor, me theks të veçantë mbi *përsosmërinë muzikore, zhvillimin edukativ dhe shkëmbimin kulturor global*. Ky edicion do të jetë një festë e muzikës dhe artit, duke promovuar si *shumëllojshmërinë* ashtu edhe *gjithëpërfshirjen*. Qëllimi i tij është të ngrisë skenën e muzikës klasike të Kosovës përmes gërshetimit të *muzikës klasike dhe bashkëkohore, edukimit* dhe diplomacisë kulturore, duke krijuar kështu mundësi të qëndrueshme për artistët dhe udhëheqësit e festivaleve.

Këtë vit, ReMusica vendos në qendër të vëmendjes *artistët vendas me karriera ndërkombëtare*, duke i bërë bashkë ata nga vende të ndryshme. Programi përfaqëson frymën e bashkimit, teksa këta artistë angazhohen në partneritete kuptimplota dhe shkëmbejnë perspektivat e tyre unike.

Përveç këtyre performancave bashkëpunuese, këtë vit Festivali ReMusica është nikoqir i *mysafirëve ndërkombëtarë*, përfshirë udhëheqës të festivaleve europiane, organizata dhe anëtarë të medias ndërkombëtare, etj. Mysafirët do kenë privilegjin të përjetojnë festivalin në mënyrë *unike*, të *eksplorojnë* komunitetin artistik vendas dhe të hapin rrugë për mundësi dhe *bashkëpunime në të ardhmen*.

Në zemër të festivalit zë vend *pasioni dhe përkushtimi i artistëve* të përfshirë, që kanë një ndikim të rëndësishëm në komunitetet e tyre, nga talentet lokale deri te yjet ndërkombëtarë.

Edicioni i 23-të me mbi **200 pjesëmarrës** nga Kosova, Belgjika, Franca, Portugalia, Austria, Gjermania, Spanja, Italia dhe nga e gjithë Europa, do t'ofrojë një program të gjerë, duke filluar nga *Koncertet*: me artistët më të çmuar të skenave botërore dhe vendore; *Diskutime*: Panele diskutimi me tema të rëndësishme si qëndrueshmëria dhe praktikrat mjedisore brenda industrisë duke synuar krijimin e një platforme për dialog ekspertësh dhe shkëmbim idesh; *Koncertet akusmatike & elektroakustike*; *Rrjetëzim*: mundësi për rrjetëzim, bashkëpunim dhe krijim lidhjesh midis artistëve vendas, mysafirëve ndërkombëtarë, krijuesve të festivaleve dhe profesionistëve të industrisë; *Programi Edukativ* - punëtori dhe masterklasa, një mjedis dinamik dhe të pasur ku artistët, studentët dhe dashamirët e muzikës mund të bashkohen për të shkëmbyer ide, ndërtuar lidhje dhe frymëzuar njëri-tjetrin.

Poashtu, Festivali do të përfshijë një gamë aktivitetestesh, duke përfshirë programin tradicional *ReMusica Junior* për fëmijë, punëtori, programin *ReNew* për artistë të rinj dhe shumë më tepër.

Në këtë frymë bashkimi, Festivali ReMusica ju fton të gjithëve të jeni pjesë e festës që tejkalon kufijtë dhe bashkon kulturat përmes muzikës.

Donika Rudi
Drejtoreshë Artistike e Festivalit ReMusica

TOGETHERNESS - A Celebration of Music, Diversity, and Enduring Connections

Under the theme of "Togetherness," the 23rd edition of the ReMusica Festival presents a comprehensive programme over four days, placing a strong emphasis on *musical excellence*, *educational growth*, and *global cultural exchange*. The festival promises to be a celebration of music and art, fostering both *diversity* and *inclusivity*. Its aim is to enhance Kosovo's classical music scene through a mix of classical & contemporary music performances, education, and cultural diplomacy, thereby creating lasting opportunities for artists and festival makers.

This year, ReMusica shines a spotlight on *local artists with international careers*, uniting them from various countries for collaborative ventures. The programme embodies the spirit of togetherness as these artists engage in meaningful partnerships and exchange their unique perspectives.

In addition to these collaborative performances, the ReMusica Festival is a host to *prominent international guests*, including festival programmers, organisations, and members of the media. The guests will have the privilege to *experience* the festival, *explore* the local artistic community, and *collaborate* to pave the way for future opportunities and collaborations.

At the heart of the festival lies the *passion* and *dedication* of the artists involved, from local talents who have made a significant impact in their communities to the international stars.

The 23rd edition, with over **200 participants** from Kosovo, Belgium, France, Portugal, Austria, Germany, Spain, Italy among countries throughout Europe and beyond, will offer a diverse programme of concerts - with remarkable international and local artist; *Discussions and artist talks*: Thought-provoking panel discussions on important topics such as sustainability, and environmental practices within the industry. These panels aim to foster a platform for expert dialogue and idea exchange; *Educational Programme - workshops and masterclasses*, dynamic and enriching learning environment where artists, students, and music enthusiasts can come together to exchange ideas, build connections, and inspire one another.

Networking: The festival will provide opportunities for networking, collaboration, and building connections among local artists, international guests, festival makers, and industry professionals coming from Europe; *ReMusica Junior*: The festival will feature a range of activities, including the traditional programme; *ReNew* programme for emerging artists and much more!

In this spirit of togetherness, ReMusica Festival invites all to join in a "fiesta" that bridges borders and unites cultures through music.

Donika Rudi
Artistic Director of ReMusica Festival



TUESDAY Festivals around table

05.11.2024

Europe House Pristina,
Kosovo | 11:00



Festalet rreth tryezës:

Qyteti dhe festalet

Diskutimi eksploron marrëdhënien midis festivele dhe qyteteve. Çfarë mund t'i ofrojnë festalet një qyteti dhe çfarë mund të bëjë një qytet për festalet? Gjatë bisedës së hapur me festivalet do t'shqyrtojmë marrëdhënien dhe përfitimet e ndërsjella. Për më tepër, do të eksplorojmë se si festalet pasurojnë botën kulturore të qyteteve.



TUESDAY

05.11.2024

Europe House Pristina,
Kosovo | 11:00

ReMusica Junior

Ndërtojmë instrumente muzikore me materiale ricikluese

Në këtë punëtori interaktive dhe krijuese, fëmijët do të përjetojnë një udhëtim praktik për të ndërtuar instrumentet e tyre muzikore duke përdorur materiale ricikluese. Ata do të mësojnë se si shishet, kanaçet, kartoni dhe materialet tjera mund të shndërrohen në instrumente. Kjo punëtori nxit kreativitetin, por gjithashtu u mëson fëmijëve rëndësinë e qëndrueshmërisë dhe ndërgjegjësimit mjedisor duke demonstruar se si materialeve të ripërdorura mund t'u jepet jetë e re në një mënyrë argëtuese dhe kuptimplote.





ELBENITA KAJTAZI soprano



PETRIT ÇEKU guitarist



SIMON MUNDY columnist
in Eye on London & Writer in
Residence Continuo Connect

TUESDAY

05.11.2024

📍 Barabar Centre Prishtinë,
Kosovë | 14:00

MEET THE ARTISTS

*The conversation delves into their artistic journeys,
inspirations, and personal stories*

Bisedë me artistë: Tregime frymëzuese

Një bisedë personale, frymëzuese dhe mbresëlënëse me artistë të njohur si sopranoja Elbenita Kajtazi, kitaristi Petrit Çeku dhe kolumnistin e Eye On London, Simon Mundy. Në këtë bashkëbisedim do të kemi rastin të dëgjojmë copëza nga rrugëtimi krijues i këtyre artistëve, frymëzimin i cili ia ka përmbushur pasionin dhe sfidat me të cilat janë përballur.



TUESDAY **Pocket concert**

05.11.2024

📍Barabar Centre Prishtinë,
Kosovë | 16:00

MARGHERITA BERLANDA accordion

Program *M. Tsangaris, R. Vetrano, S. Odeh-Tamimi, A. Sowa*

Koncert xhepi me fizarmonisten italiane Margherita Berlanda për "ON THE EDGE", një koncert bindës që eksploron kufijtë, sfidat dhe vetë-zbulimin. Nëpërmjet performancës së saj mjeshtërore, Berlanda shtyn kufijtë e instrumentit të saj, duke ftuar audiencën të reflektojë mbi elasticitetin dhe transcendencën.

Program

Magnus Tsangaris (1956)
Viscum album I and II for
accordion

Roberto Vetrano (1982)
ACUSTICA III for accordion
and ghost sounds
(2022 - premiere Rondo
Festival Divertimento
Ensemble)


Samir Odeh-Tamimi (1970)
Tsalim (Schatten) for
accordion solo

Anna Sowa (1987)
minimal ANIMAL for an
accordion and electronics
(2024 - premiere
Unerhörte Musik Festival
Berlin)

Magnus Tsangaris (1956)
Viscum album III and IV for
accordion

Margherita Berlanda,
accordion

Margherita Berlanda është një fizarmonikiste italiane poliedrike, veçanërisht e përkushtuar ndaj kërkimeve në fushën e muzikës bashkëkohore. Kërkimi përmes shprehjeve të ndryshme estetike dhe artistike ka luajtur një rol qendror në kërkimin e saj personal dhe e ka bërë atë t'i afrohet me fushën e performancës. Fokusi i saj në artet bashkëkohore ia ka mundësuar bashkëpunimin me kompozitorë të ndryshëm, si Samir Odeh-Tamimi, Giorgio Colombo Taccani, Manuela Kerer, Anna Sowa, Farzia Fallah, Marco Momi, Sidney Corbett dhe Nikolaus Brass. Ajo ka interpretuar për festivale të njohura ndërkombëtare si Bienalen Ndërkombëtare Koper, Milano Musica, Rondo Festival Milan, Transart Festival Bozen, Traiettorie Festival Parma, Unerhörte Musik Festival Berlin, Society Filarmonica Trento dhe shumë të tjera.



TUESDAY

05.11.2024

Concert

ELBENITA KAJTAZI soprano
ELDA LARO piano

Program Ardian Gega, G.Fauré, C.Deussy,
F. Liszt, E.W.Korngold, M.G. Puccini, J.Massenet, J.
Rachmaninov, P.I.Tschaikovsky,

📍 Atelieja e Pallatit të Rinisë
Prishtinë, Kosovë | 19:00

Program

Trembem

Claude Debussy

Apparition Suite

bergamasque, L.75: III. Clair
de lune

Franz Liszt

Die Lorelei S.273

Erich Wolfgang Korngold

Mariettas Lied opera Die
tote Stadt

Vier fröhliche Walzer, II.
Margit

Charles Gounod

"Amour, ranime mon
courage" Roméo et Juliette

Giacomo Puccini

"Senza mamma" - Suor
Angelica

Sergei Rachmaninov

Elegie op.3 nr.1

Peter Ilich Tschaikovsky

"Tatiana's letter" - Eugene
Onegin

Elbenita Kajtazi Sopranoja kosovare Elbenita Kajtazi është operistja kryesore e Operës Shtetërore të Hamburgut, me rolet si Micaela Carmen, rolin kryesor të Massenet Manon, Liu Turandot, Violetta La Traviata dhe Mimi La bohème. Gjatë sezonit 24/2023, Kajtazi rikthehet në Semperoper Dresden dhe Opernhaus Cyrih si Liu, dhe debutoi me Operan Kombëtare Angleze në 7 Deaths of Maria Callas; rolet në Hamburg do të përfshijnë: Violetta, Lauretta Gianni Schicchi, Manon dhe e para e saj Tatyana Eugene Onegin. Në 23/2022, Kajtazi debutoi me Bayerische Staatsoper, si Gretel Hansel und Gretel dhe Opera de Lyon, si Susanna Le nozze di Figaro dhe Micaëla Carmen në Opera Comique Paris. Në Mars 2018, ajo fitoi Çmimin e Audiencës dhe çmimin e -3të në Kupën e parë të Operas Glyndebourne. Çmimet e mëparshme përfshijnë çmimin e parë në konkursin Riccardo Zandonai. Ajo bëri debutimin e saj në Festivalin e Salzburgut si anëtare e Young Singers Project 2016 dhe përfaqësoi Kosovën në konkursin e BBC Cardiff Singer of the World 2021.

Elda Laro një nga artistet më të talentuara të brezit të saj, Elda aktualisht shërben si trajnere, pianiste dhe dirigjente stafi në Deutsche Oper Berlin. Një fëmijë mrekulli, ajo shfaq talentin e saj vetëm në moshën -11vjeçare duke interpretuar Koncertin e Pianos Nr. 1 të Beethoven me Orkestrën Kombëtare Shqiptare. Ajo u diplomua me nderime të larta në Torino dhe i përmirësoi më tej aftësitë e saj në Paris. Në sezonin 2025-2024, Elda do të debutojë në Filharmoninë e Berlinit, duke dirigjuar Meshën e Shën Cecilisë të Gounod dhe Mendelssohn's The First Walpurgis Night. Ajo gjithashtu do të dirigjojë një koncert gala në RLIOF në Nju Jork. E përkushtuar ndaj nxitjes së talenteve të reja, ajo drejton klasa master globalisht, duke përfshirë një seminar të fundit në Dubai. Elda ka dirigjuar disa premiera botërore në Deutsche Oper. Ajo do të interpretojë Burleskën e Strauss-it me Filharmoninë e Neubrandenburgut dhe do të dirigjojë një program të muzikës së dhomës në Berlin.



TUESDAY

05.11.2024

Concert

SIPARANTUM CHOIR
MEMLI KELMENDI conductor

*Program J. Ames, Baki Jashari, M.Mcglynn, F.Ticheli,
J.V.Roost, K.Gimon, J.Poelinitz, J.Neske, J.Runestad, S.Vovk*

📍 Atelieja e Pallatit të Rinisë, Prishtinë,
Kosovë | 19:00

Program

Jeffery Ames

Tshotsholoza Traditional
South African

Michael McGlynn

Media Vita
Leon Shehu, vocal, Fidan
Strumcaku, shaman drum

Jan Van der Roost

Amor io fallo

Katerina Gimon

Fire
Fidan Strumcaku, shaman
drum

Baki Jashari

Pakëz në ëndërr, pakëz
në zhgënder (Little in the
dream, little awake)
Aurora Hyseni, recitator

Josephine Poelinitz

City called heaven,
traditional spiritual
Erijon Palucaj, solo,
Denita Dedushaj, piano

Jake Runestad

Nyon, Nyon

Samo Vovk

Ta na solbici

Siparantum Choir Kori Siparantum është kori më i njohur në skenën e muzikës kosovare, i dalluar për promovimin e kulturës kombëtare dhe ndërkombëtare. Themeluar në vitin 2017 dhe nën drejtimin e dirigjentit Memli Kelmendit, kori ka fituar njohje të madhe me 15 çmime ndërkombëtare, përfshirë Medaljen e Artë (Champions Competition) – Mixed Choir në World Choir Games, Kore e Jugut (2023), Medaljen e Artë në European Choir Games & Grand Prix of Nations, Suedi (2023), dhe Çmimin e Parë në Kategorinë G në European Festival for Young People, Neerpelt, Belgjikë (2024).

Repertori i tij përfshin muzikë klasike dhe bashkëkohore, me bashkëpunime me dirigjentë dhe kompozitorë të njohur si Simon Carrington, Eriks Ešenvalds, Robin Tyson, , Petr Popelka, Heinz Ferlesch, Josip Degl' Ivellio, Mihaly Zeke etj. duke forcuar reputacionin ndërkombëtar të korit. Kori ka mbajtur koncerte dhe ka marrë pjesë në festivale prestigjioze në shumë vende, përfshirë SHBA (Washington D.C.), Gjermani, Francë, Itali, Spanjë, Kore të Jugut, Austri, Belgjikë, Zvicër, Suedi, Portugali, Kroaci, Poloni, Maqedoninë e Veriut, Slloveni dhe Shqipëri. Performancat në skena si Berliner Philharmoniker dhe Wiener Konzerthaus kanë konsoliduar famën ndërkombëtare të korit. Me mbi 140 paraqitje ndërkombëtare, kori është renditur ndër 30 grupet më të mira korale në Listën Botërore të Renditjes INTERKULTUR, duke përfaqësuar me krenari kulturën e Kosovës.

Memli Kelmendi ka përfunduar studimet pasuniversitare për dirigjim (vokal dhe instrumental) në Prishtinë, si dhe për kompozicion, produksion muzikor dhe inxhinieri të tonit në Maqedoninë e Veriut. Aktualisht, ai vazhdon studimet e doktoraturës në drejtimin koral në Shkollën e Arteve "Kirili dhe Metodi" në Shkup. Memli është anëtar i Këshillit të Koreve Botërore (WCC) - INTERKULTUR, ku përfaqëson Kosovën për herë të parë. Ai është gjithashtu anëtar i rrjetit më të madh të dirigjentëve koral në botë, World Choral Conducting Network (WCCN). Kompozimet e tij më të njohura përfshijnë "Agnus Dei," "Ater Umbra," "Silentium Est Pax," "Pax," "Renuo," "Dies Lunae," etj. Ai njihet gjithashtu si kompozitor i cili ka shkruar muzikë për më shumë se 40 shfaqje teatrale dhe mbi 50 filma.



WEDNESDAY Festivals around table

06.11.2024

📍Institut Français du Kosovo,
Prishtinë, Kosovë | 09:30


Artistët dhe festivalet rreth tryezës:

Rëndësia e përkrahjes së artistëve në zhvillim si pjesë e programit të festivaleve.

Pse duhet të pëfshihen në programet e festivaleve artistët në zhvillim? Cilat janë përfitimet për të dyja palët, artistët dhe festivalet? Diskutim për përfitimet për kompozitorë dhe programerët.

Me Marti Sancliment (Jordi Savall Festival), Fjolla Gashi (kompozitore), Jean Baptiste Zellal (kompozitor), Margherita Berlanda (artist), Esther Kretzinger (Kulturhaltestelle / Weissenhorn Klassik Festival) Ersan Januzi (kompozitor), Dea Ahma (kompozitore), Memli Kelmendi (kompozitor), Fjolla Gashi (composer), Sovran Nrecaj (artist).

Moderuar nga Simon Mundy, kolumnist në Eye On London dhe Writer in Residence në Continuo Connect



WEDNESDAY ReMusica Junior

06.11.2024

📍Autostrada Biennale Hangar,
Prizren, Kosovë | 12:00

ReMusica Junior: Bota e tingujve

Bashkohuni me ne në zbulimin dhe eksplorimin e botës së tingujve. A e dëgjoni hapësirën përreth jush? A mund t'i ndjeni tingujt që udhetojnë rreth jush? Qofshin ata tinguj të lehtë, të butë, të fortë, të shpejtë apo të ngadaltë. Dëgjoni me kujdes tingujt e valëve të detit, shushurimën e erës, kafshët. Jean Baptiste Zellal do t'ju udhëheqë në këtë udhëtim imagjinar. Ejani të eksplorojmë së bashku botën e tingujve!



WEDNESDAY **Pocket concert**

06.11.2024

📍 Autostrada Biennale Hangar,
Prizren, Kosovë | 15:00

Acousmatic Concert
JEAN BAPTISTE ZELLAL

*Program Jean-Baptiste Zellal, Loup Mormont,
Sophie Delafontaine, Jean-Baptiste Zellal*

Koncert xhepi me vepra të muzikës akusmatike të spacializuara në oktofoni nga Jean Baptiste Zellal. Përjetoni magjinë e botës së tingujve.

Jean-Baptiste Zellal ka kompozuar muzikë për koncerte dhe arte skenike për më shumë se 15 vjet, i specializuar në vepra profesionale për teatër, kërcim, poezi dhe projekte të artit dixhital. Në vitin 2017, ai përfundoi masterin në kompozim akusmatik nga Arts2 École Supérieure des Arts në Mons, duke studiuar nën mbikqyrjen e instruktorëve me famë si Philippe Mion, Benjamin Thigpen dhe Annette Vande Gorne. Kompozimet dhe performancat e tij shfaqen rregullisht si në Belgjikë ashtu edhe ndërkombëtarisht, duke përfshirë ngjarje si Festivali L'Espace du Son (Bruksel), Ina/GRM (Paris), Festivali MANCA (Nice), JIME (Amiens), ReMusica (Prishtinë), CIME (Moskë), dhe Totem Électrique (Montreal). Jean-Baptiste drejton edhe aktivitete edukative, duke ofruar mësimë muzikore për fëmijë, amatorë dhe muzicentë profesionistë në zhvillim në mjedise të ndryshme si universitete, akademi, shkolla dhe qendra kulturore.



WEDNESDAY **Pocket concert**

06.11.2024

📍 Autostrada Biennale Hangar,
Prizren, Kosovë | 15:00

WIND ENSEMBLE

NITA KRAJKU flute, XHOVANA MARKU oboe,
MALBORË KRAJKU clarinet, ZANË XHULI bassoon,
ARDITA IBRAHIMI horn

Koncerti i xhepit me "Windway Ensemble" është një koncert që eksploron kufijtë dhe sfidat. Përmes performancës së tyre, 'Windway Ensemble' fton publikun të shijojë muzikën klasike përmes këndvështrimeve të ndryshme.

Program


Hedwige Chrétien

Quinttete à Vent, 2 & 1
mvm

Česk Zadeja

Suitë nga Baleti "Delina"

Ansambli Windway është kuintet vajzash i krijuar në vitin 2018 në Prizren. Repertori i këtij kuinteti përbëhet nga vepra të muzikës klasike si dhe vepra të muzikës shqipe shkruar për këtë formacion. Ndër vite kanë organizuar disa koncerte recitale në qytete të ndryshme të Kosovës, kanë performuar në festivale si Festari dhe DokuFest, si dhe kanë qenë pjesë e programeve për festa kombëtare. Ansambli ka qenë pjesë e Frymon Festival në Shqipëri. Anëtarët e grupit (Nita Krajku, flaut; Xhovana Marku, oboa; Malborë Krajku, klarinetë; Ardita Ibrahim, kornë; dhe Zanë Xhuli, fagot) janë instrumentiste të orkestrave të ndryshme në Kosovë si: Filharmonia e Kosovës, Opera e Kosovës, Orkestra Frymore e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Orkestra Simfonike e Gjakovës dhe Orkestra Frymore Prizreni.



WEDNESDAY Festivals around table

06.11.2024

📍 Autostrada Biennale Hangar,
Prizren, Kosovë | 15:00

The Role of Festivals in Climate
Action and Environmental
Awareness towards Net-Zero

Festivalet rreth tryezes:

Roli i Festivaleve në veprimin për klimën dhe ndërgjegjësimin mjedisor drejt Net-Zero: Diskutimi do të eksplorojë se si festivalet e muzikës klasike mund të luajnë një rol të rëndësishëm në avancimin e veprimit klimatik dhe rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit. Ky sesion fokusohet veçanërisht në kontributin e këtyre festivaleve në promovimin e veprimit klimatik dhe ndërgjegjësimit mjedisor. Festivalet evropiane do të marrin pjesë në diskutim për të ndarë praktikatat, strategjitë dhe përvojat e tyre në zbatimin e nismave të qëndrueshme dhe angazhimin e komuniteteve të tyre në këtë bisedë kritike.



FRIDAY **Promovim i librit**

08.11.2024

Barabar Centre Prishtinë,
Kosovë | 12:00

Skena Muzikore e Prishtinës
Festivali i Parë i Muzikës
Klasike në Kosovë (1974 - 1988)

*Jubileu i 50 vjetorit të themelimit
Autore Kristina Palokaj Perkola*

Kristina Palokaj Perkola muzikologe e shquar nga Prishtina, me doktoraturë të përfunduar në Akademinë e Muzikës në Universitetin e Zagrebit, nën udhëheqjen e muzikologut, akademikut Stanislav Tuksar. Kërkimet e saj fokusohen në muzikologjinë historike të Kosovës dhe rajonit, me punime të shumta të publikuar në revista shkencore në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Kroaci, Turqi, Austri etj. Ajo ka disa libra të botuar "Dy jetë për muzikë", kushtuar Rexho Mulliqit dhe Nexhmije Pagarushës, "Solfegjo fillestare" koautore me Violeta Krasniqin, i pari i këtij lloji pas luftës në Kosovë. Nga viti 2005-2022, ka qenë udhëheqëse e korit të Katedralës "Shën Nënë Tereza" në Prishtinë, bashkëpunëtore e Radio Marisë së Kosovës dhe anëtare e Shoqatës së Muzikologëve të Kroacisë.



WEDNESDAY

06.11.2024

Concert

RAQUEL ANDUEZA soprano
JESUS FERNANDEZ BAENA
theorbo

*Program E. Radesca, F. Cavalli, J. Lully, M. Charpentier, J.
de la Barre, Spanish and Italian music of the 17th Century*

📍 Katedralja "Zoja Ndihmëtare" Prizren,
Kosovë | 19:00

Program

La Ausencia

Anonymous (XVIIth Century)

De mis tormentos y enojos

Anonymous (XVIIth Century)

Si vos pretendéis quererme

Enrico Radesca (1625 - 1570)

Vieni in questo seno

Francesco Cavalli (1676 - 1606)

Tarantella

Anonymous (XVIIth Century)

Arrojome las naranjicas

Anonymous (XVIIth Century)

Vuestros ojos

Anonymous (XVIIth Century)

Sé que me muero de amor

Jean-Baptiste Lully (- 1632
1687)

Sans frayer dans ce bois

Marc-Antoine Charpentier
(1704 - 1643)

Si c'est un bien que

l'espérance

Joseph Chabanceau de la
Barre (1678 - 1633)

Esta noche soné un sueño

Anonymous (XVIIth Century)

Jácara de la Treña

Anonymous (XVIIth Century)

Raquel Andueza and Jesus Fernández Baena

Duet shumë i vlerësuar në muzikën e hershme, për performancat në salla dhe festivale kryesore evropiane. Interpretimet e tyre të ngrohta sjellin një perspektivë të freskët mbi muzikën e lashtë, duke i ofruar audiencës mundësinë e rizbulimit të veprave dhe kompozitorëve dhe ndjesinë nga e kaluara.

Raquel Andueza aktualisht këndon si soliste në festivalet dhe sallat kryesore në mbarë botën. Në vitin 2012, ajo bëri debutimin e saj në New York në CarnegieHall dhe gjithashtu në London Proms. Raquel Andueza ka performuar me dirigjentë të njohur si Pablo Heras Casado, William Christie, Fabio Biondi, Emilio Moreno. Në vitin 2011, së bashku me Jesus Fernández Baena, ajo themeloi grupin Raquel Andueza & La Galania, ku fitoi çmimin FestClásica, dhe në vitin 2014 dhe 2019 çmimin për Grupin më të Mirë të Muzikës Barok, të cilin ua dha Shoqata e Grupeve të Muzikës së Hershme Spanjolle; në vitin 2020 ata ishin fitues të Çmimeve MIN për albumin më të mirë të muzikës klasike ("El baile perdido"). Raquel ka bërë regjistrime për produksione si Virgin Classics, Glossa, K617, NB Musika, Accentus dhe Zig-Zag Territoires. Në vitin 2011 ajo krijoi produksionin e saj, Anima e Corpo, incizimet e të cilit kanë marrë vlerësimet dhe çmimet më të mira nga shtypi i specializuar.

Jesus Fernández Baena, theorbo studioi për flaut dhe lahutë në Conservatorio Superior de Musica de Sevilla dhe vazhdoi shkollimin e tij në Koninklijk Conservatorium të Hagës, ku u diplomua në vitin 2002. Ai ka bashkëpunuar me shumë ansamble, duke përfshirë Private Musicke dhe El ConciertoEspanol, dhe bashkë-themeloi ansamblin La Galania në vitin 2010 me sopranon Raquel Andueza, duke performuar në mbarë botën. Jesus ka punuar me dirigjentë të njohur si Frans Brüggen dhe Gabriel Garrido, dhe rregullisht shoqëron këngëtarë të njohur. Ai ka bërë incizime për radioa stacione dhe produksione të ndryshme, dhe në vitin 2011 lansoi produksionin e tij, Anima e Corpo, i cili ka publikuar gjashtë albume shumë të vlerësuara.



WEDNESDAY

06.11.2024

Concert

ReVocal Ensemble

ANDRA REXHEPI ALT, ELONA SADIKU SOPRANO, DIELLZA SYLEJMANI ALT, FATJON GASHI TENOR,
KALTRINA MIFTARI SOPRANO, NIKOLL GJINI BAS, RIZAH JAHAJ TENOR, SAFET BERISHA TENOR,
SHABAN BEHRAMAJ BARITON, SHKURTA HYKAJ REXHEPI SOPRANO

RAFET RUDI CONDUCTOR

*Program Mendi Mengjiqi, L.Jëkabsone, C. Monteverdi, Rafet Rudi,
J. Dowland, Ē. Ešenvalds, M. Lauridsen, A.Lotti, Lorenc Antoni, Jan
Kukuzel, J. Runestad, W. Byrd*

📍 Katedralja "Zoja Ndihmëtare" Prizren,
Kosovë | 19:00

Program

Eric's Ešenvalds
Stars

Morton Lauridsen
O Magnum Mysterium

Mendi Mengjiqi
OEIA

William Byrd
Haec dies

Antonio Lotti
Crucifixus

Claudio Monteverdi
Lamento della Ninfa

Laura Jekabsone
Kuulin aanen (Finnish folk song)

Lorenc Antoni (Albanian folk song)
Çorapet e burrit

Rafet Rudi
Një tokë, një kokë

Jake Runestad
Nyon Nyon

ReVocal Ensemble është ansambël i formuar nga Festivali ReMusica. Ai karakterizohet me repertor të gjerë stilistik, duke filluar nga muzika e vjetër shqiptare - renesansë dhe barok, me kompozitorët Gjergj Danush Llapacaj, Jan Kukuzeli (i cili njihet si reformator i notacioni të kishës lindore), repertori modern shqiptar, e deri te repertori botëror bashkëkohor. Nën udhëheqjen e dirigjentit Rafet Rudi, dhjetë profesionistë janë bashkuar për të shpalosur muzikën korale me një finesë dhe ndjeshmëri interpretative. Programi i ansambllit vokal ReMusica paraqet një zhytje të madhe në thesarin historik të muzikës shqiptare (deri vonë të panjohura për historografinë shqiptare) të shekullit XIII dhe XIV me kompozitorët Gjergj Danush Llapacaj, Jan Kukuzeli (i cili njihet si reformator i notacioni të kishës lindore) dhe duke vazhduar deri te krjimtaria e kompozitorëve të gjeneratës së re nga Kosova dhe repertoari modern botëror.

Rafet Rudi, në jetën muzikore të Kosovës, me veprimtarinë tij si kompozitor, dirigjent, mendimtar i shprehur në fushën e publicistikës dhe filozofisë së muzikës, anëtar i Akademisë Europiane të Shkencës dhe Arteve, paraqet personalitetin më të spikatur dhe më aktiv në 3-2 dekadat e fundit. Rudi ishte dirigjent i Korit Profesional të Radio Televizionit të Prishtinës (RTP) në periudhën 1987-1980 dhe me këtë ansambël koncertoi në të gjitha vendet e ish Jugosllavise. Ai ishte prezent në Festalet e rëndësishme të kohës, si Festivali i Dubrovnikut, Ohrit, Beogradit, Festivali i muzikës moderne në Opatit (Kroaci) etj. Në vitet - 2006-2020, ai udhëheqë Korin e Filharmonisë të Kosovës dhe realizon qindra paraqitje publike me programe a capella në Kosovë, Angli, Maqedoni të Veriut, Kroaci, Shqipëri, Itali etj. Nën drejtimin e tij, Kori dhe Orkestra e Filharmonisë realizojnë një mori veprash të rëndësishme vokalo-instrumentale, si: Missa D-dur e Mozartit, 'Vespro della Beata Virgine 1610' e Monteverdit, Kantata Nr. 28 e Bahut, 'Gloria' e Vivaldit, Mesha C-dur e Beethovenit, Rekuemi i Mozartit etj. Në vitet e fundit, Rudi i përkushtohet pikërisht zbulimit, restaurimit dhe adaptimit të literaturës korale të autorëve të vjetër shqiptarë, si Gjergj Danush Llapacaj (shek. XVI), Jan Kukuzeli (shek. XIII) dhe Niketa i Remisianës (shek. IV).



TUESDAY

07.11.2024

Concert: ReMusica Junior

**CHILDREN'S ORCHESTRA
OF PRISTINA**

Vehbi Shosholli conductor

*Program N. Rota, D. Shostakovich, P. Gaci, A. Menken, S.
Kolonja, F. Ibrahim, J. Strauss, R. Krasniqi*

📍 **Atelieja e Pallatit të Rinisë Prishtinë,**
Kosovë | 12:00

Program

Nino Rota

Love Theme from Romeo
& Juliet

Dimitri Shostakovich

Waltz from Jazz Suite

Pjetër Gaci

Për ty atdhe
Kori i shkollës & soliste:
Leona Ferati

Alan Menken

Arabian Nights

Selami Kolonja

Pse jemi të ndarë
Orchestra and choir.
Soloist: Leona Ferati

Feim Ibrahim

Rrjedh në këngë e ligjërimi
Orchestra and choir.
Soloist: Leona Ferati

Johann Strauss

Radetzky March

Rashid Krasniqi

Mallëgjimi
Orchestra and choir.
Soloist: Arjona Ramadani

ReMusica Junior: Orkestra e fëmijëve "Amadeus" Orkestra e fëmijëve "Amadeus"

është themeluar në vitin 2015, fillimisht me një numër të vogël nxënësish. Duke parë potencialin e muzicentëve të rinj, si dhe rëndësinë e edukimit muzikor në formimin e hershëm të fëmijëve, orkestra vazhdon të bashkojë të gjithë nxënësit e talentuar nga shkollat e muzikës në Prishtinë. Me mbështetje nga Komuna e Prishtinës dhe në bashkëpunim me Shkollën Publike të Muzikës «Prenk Jakova», orkestra bashkon talentet e të rinjve muzikantë të qytetit. Nën udhëheqjen e dirigjentit Vehbi Shosholli, orkestra ka organizuar një sërë koncertesh të rëndësishme në qytete të ndryshme të Kosovës dhe jashtë saj.

ReMusica Junior: Amadeus Children's Orchestra The Amadeus Children's Orchestra was

founded in 2015, initially with a small number of students. Recognizing the potential of these young musicians, as well as the importance of music education in the early development of children, the orchestra continues to bring together talented students from music schools in Pristina. With support from the Municipality of Pristina and in collaboration with the Public Music School «Prenk Jakova,» the orchestra unites the city's young musical talents. Under the leadership of conductor Vehbi Shosholli, the orchestra has organized a series of significant concerts in various cities across Kosovo and abroad.

THURSDAY

07.11.2024

ReNEW

DIAR ALIU

Program Ardian Gega, G.Faurè, C.Debussy,
F. Liszt, E.W.Korngold, M.G. Puccini, J.Massenet, J.
Rachmaninov, P.I.Tschaikovsky,

📍 Atelieja e Pallatit të Rinisë
Prishtinë, Kosovë | 19:00



Program

Mauro Giuliani

Grande Ouverture, Op. 61

Federico Moreno Torroba

Castillos de Espana

Alcaniz

Siguenza

Alcázar de Segovia

Torija

Turegano

Mario Castelnuovo-Tedesco

Tarantella

Krzysztof Penderecki

Aria & Cadenza

Heitor Villa-Lobos

Cadenza

Mario Castelnuovo-Tedesco

Quintetto for Guitar and
String Quartet, Op. 143 (IV
movement)

